

NË EMR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti për Krime të Rënda, në trupin gjykues të përbeër prej gjyqtarit Xheladin Osmani, si kryetar dhe gjyqtarve Ajser Skenderi dhe Refki Piraj, si anëtar të trupit gjykues, në lenden penale kunder të akuzuarve S. J. , nga fshati , H. K. nga fshati , A.Sh. nga fshati , H. B. nga fshati , A. G. nga fshati dhe B. G. nga fshati , Komuna e Suharekës, për shkak si bashkëkryës të veprës penale keqperdorimi i pozites apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me par.2.1,2.2dhe 2.4 të KP, e lidhur me nenin 31 të KP, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, PP.nr.258/2015, e dt.17.12.2015, pas mbajtjes së shqyrtimeve kryesore publike, më datë 16.05.2016, 18.06.2016, 13.10.2016, 11.11.2016, 21.12.2016, 20.01.2017, në prezencen e prokurorit të shtetit Ervehe Gashi, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre, av. N. H. , O. Z. , S. H. , F. Sh., A, B, dhe N. Q. , më dt.25.01.2017, muar dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1.S.J., nga i ati H. dhe e ëma Z. me mbiemër të vajzërisë T., i lindur me “data e lindjes...” në fshatin , Komuna e Suharekës, ku edhe përherë jeton, shqiptar, shtetas i R.Kosovës, ka të kryer akademinë pedagogjike, me profesion pensionist i martuar, baba i 4 fëmijëve, gjendja e mesme ekonomike.

2 H.K. , nga i ati H., dhe e ëma S., me mbiemër të vajzërisë V., i lindur me “data e lindjes...” në fshatin , Komuna e Suharekës, ku edhe përherë jeton, shqiptar, shtetasi R.Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, me profesion roje pyelli, i martuar baba i 4 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike.

3.A.Sh., nga i ati Z., dhe e ëma H., me mbiemër të vajzërisë M. , i lindur me “data e lindjes...” në fshatin , Komuna e Suharekës, ku edhe përherë jeton, shqiptar, shtetas i R.Kosovës, ka të kryer shkollëne mesme ekonomike, me profesion kujdestar parku, i martuar baba i 3 fëmijëve.,

4.H.B. , nga i ati Xh., dhe e ëma H. ,me mbiemër të vajzërisë G. , i lindur me “data e lindjes...” në fshatin , Komuna e Suharekës, klu edhe përherë jeton, shqiptar shtetas i R.Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion roje pyelli, i martuar baba i 3 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike.

5.A.G. , nga i ati R. dhe e ëma H. , me mbiemër të vajzërisë A. , i lindur me “data e lindjes...” në fshatin komuna e Suharekës, ku edhe përherë jeton, shqiptar, shtetas I R.Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion roje pylli, i martuar, baba i 5 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike.

6.B.G. , nga i ati nga i ati D. , dhe e ëam Sh. , me mbiemër të vajzërisë A. , i lindur me “data e lindjes...” në fshatin , Komunina e Suharekës, ku edhe përherë jeton, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion roje pyelli, i martuar, baba i 3 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike.

JANË FAJTORË

Me date 04.korrik 2015, në mes të ores 05:00 dhe 08:10 minuta, i pandehuri S.J. në cilësi të personit zyrtar edhe atë përgjegjës i Njësisë komunale për pylltari komunale në suharekë, të pandehurit H.K. , H.B., A.G., dhe B.G. në cilësi të personit zyrtar, dhe ate roje pyelli dhe A.Sh. në cilësin e personit zyrtar kujdestar (roje) i natyrës, duke e shfrytëzuar detyrën e tyre zyrtare, si bashkëkryerës nuk i përmbushi detyrat zyrtare të tyre me qëllim të përfimit të çfarëdo dobie për personin tjetër dhe shkaktimin e demit një personi tjetër dhe me atë rastë shkelin me dashje ligjin lidhur me detyrat e tyre zyrtare, në atë mënyrë që të pandehurit duke u larguar nga vendi i ngjarjes “...”, e cila administrohet nga Drejtoria për pylltari, bujqësi dhe zhvillim rural i Komunës së Suharekës, mundësojnë që keqbërësit Xh.D. dhe R.H. , që të dy nga fshati , Komuna e Suharekës, ti largojnë traktorat e tyre të tipit “Rakovica” të ngarkuar me dru të prera në mënyrë ilegale në bjeshkët e fshatit e cila administrohet nga parku kombëtar “sharri”, nëpërmes rrugës së vetme që kalon në afërsi të arës së “.....” traktor këta të clët policia së bashku me dëshmitarin H.K.1 i kishte identifikuar dhe fotografuar me date 03.korrik 2015, me ç’ rast parku kombëtar “sharri” i është shkaktuar dëm në vlerësn e druve të prera të ahut.

Këso dore si bashkryerës kanë kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me par.2.1,2.2dhe 2.4 të KP, e lidhur me nenin 31 të KP.

Andaj ,Gjykata në bazë të nenit 7,8,9,10,41,49, 51,52, 73,74 75, 76 dhe nenit 422 par.1 lidhur me par.2.1,2.2dhe 2.4 të KP, e lidhur me nenin 31 të KP, të akuzuarit S.J. , H. K. , A.Sh. , H.B. , A.G. dhe B.G. , ua shqipton

DENIMIN MEKUSHT

Të cileve u vertetohet denimi me burg në kohëzgjatje secili me nga 2 (dy) vite, i cili nuk do të ekzekutohet në afatin prej 2 (dy) viteve, nese të akuzuarit nga dita e plotfuqishmerislë së këtij aktgjykimi nuk kryejnë vepër të re penale.

Gjykata në kuptim të nenit 62 paR.2 P.2.3 të KPK, të akuzuarve ua shqipton:

Denimi Plotësues

Ndalimin e ushtrimit të ushtrimit të funksionevepublike në administraten publike apo në sherbimin publik, në aft kohor prej me nga 2 (dy) viteve, nga dita e plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara parku kombëtar “Sharri” , për realizimin e kerkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Obligohen të akuzuarit që të paguajë në emër të shpenzimeve procedurale dhe paushallin gjyqësor shumën secili me nga 300 (treqindë) euro, në afatin prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcnimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzen PP.nr.258/2015, ndaj S.J. nga fshati , Komuna e Suharekes, H.K. nga fshati , Komuna e Suharekës, A.Sh. nga fshati , Komuna e Suharekës, H.B. nga fshati , Komuna e Suharekës, A.G. nga fshati , Komuna e Suharekës, dhe B.G. nga fshati Komuna e Suharekës, për shkak si bashkryes të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me par.2.1,2.2 dhe 2.4 të KP e lidhur me nenin 31 të KP.

Aktakuzë të cilën në të gjitha fazat e shqyrtimeve kryesor ka përfaqësuar prokurori i shtetit Ervehe Gashi, i cili fjalën përfundimtare, gjykatës ia ka deponuar me shkrim kun ë fund konsideron se në veprimet e të pandehurëve qëndrojnë elementet esenciale të veprës penale për të cilën janë përgjegjës në aspektin penalo-juridik dhe propozojë që të njejtit të shpallen fajtor dhe t' ia shqiptojë dënimet e parapara me Ligj gjithashtu në kuptim të nenit 162 par.2.2 të KP të pandehurëve ti shqiptohet dënimi plotësues, ndalimi i ushtrimit të detyrave udhëheqëse dhe menaxheriale në insitucionet publike.

Mëqë të akuzuarit S.J. , H.K. , A.Sh. , H.B. , A.G. dhe B.G. , nuk kanë pranuar fajsin, gjykata pastaj administroj me provat, në shqyrtimin kryesor të dt 16.05.2016 degjoj deshmitarin H.K.1 , në shqyrtimin kryesor të dt. datën 18.05.2016, degjoj deshmitaret I. S. , më shqyrtimin kryesor të dt.13.10.2016, deshmitaret Sh.B. , M.H. , Xh.K. , H.D. , Xh. E. dhe Xh.D. , 21.12.2016 me, është bërë leximi i raportit informues të datës 13.nëntor 2015 me numër ../.. .SH/./.../.... e Stacionit policor në Suharekë, kallximi penal 2015-GB482, në raportin informues të rreshterit I.B. i datës 06.korrik 2015, me numër ../....-SM-.-.. /.... , në raportin e oficerit Sh.B. të datës 02.gusht 2015 në procesverbalin mbi konfiskimin e sонтimenteve pyjor, datë 04.korrik 2015, përgjegje e H.D.1 drejtor i DAFK “Sharri” datë 29.nëntor 2015, në marëveshje në mes të drejtorisë së parkut nacional “Malet eSharrit” dhe sektorit për pyje KK Suharekë datë 28.mars 2008, kërkesa për shfrytëzimin e deponimit për dru e konfiskuar, datë 11.qershor 2015, në kontratën e punës së datës 01.dhjetor 2010 në emër të A.Sh., autorizimi për përgjegjësit në teren e datës 07.maj 2015 dhe në shiqimin e fotodokumentacionit.

I akuzuari S.J. , në fillim deklaroi se nuk e pranon fajsinë.dekleratë që e kamë dhënë një deklaratë në prokurori, me kujtohet se çka kamë deklarua dhe qëndroj pranë asaj deklarate.

Në pyetjen e avokatit mbrojtës: ju në deklaraten e juaj keni thënë se jeni takuar me M.K., Sh.B., rojtarët e parkut nacional T.L. a është e vërtetë?

I akuzuari : po, është e vërtetë. Në vendin “Arat e Ramës” kemi qëndruar prej orës 22:30 minuta, për afërisht 20 minuta, H.K.1, T.L. si njeri pa kontratë në uniformë të cilën H.K. ia ka

dhënë uniformën edhe pse unë i kam thënë H.K. “ti na ke thirre dhe ti qëndro këtu”, mirëpo ata të dytë janë larguar bashkë me dy policë tjerë aty në vend të ngjarjes kemi edhe M. K. dhe Sh. B. të cilët bashkë me H.K. kanë shku te poshtë. Aty kanë qëndruar H. K., H.B. , B. G. , A.G. dhe punëtori i parkut rojtari A.Sh. dhe policët S.A. dhe S.Sh., policët të cilët kanë qëndruar tërë kohën në vendin e ngjarjes.

Av: në shkresat e lëndës gjinden edhe disa fotografi të ngarkuar me dru, a e din se nga kanë ardhë ato fotografi?

I akzuar: unë nuk kam pa traktorat e ngarkuar dhe nuk e di ku janë bërë ato fotografi.

Drut të cilët kanë qenë tek “...” në sasi prej 6 kubik apo 8 m² kanë qenë aty, ato të nesërmen i kemi qar në fshatin në depo bashkë me policinë, të cilat i ka bartur një kompani policë kanë qenë D.Sh. polic dhe F. J. . Këto dru i kemi transportu prej orës 07:00 të mëngjesit deri në ora 19:00 në mbrëmje, përveç turrave të druve të cilat i kemi pasur tek “....” më naltë tek “stanet e S. S.” kemi hasur 2 turra dru njëra turrë ka patur 6 m³ kurse tjera 3, e gjithsejtë bëjnë 15m³. Largësia vendi “....” prej “Stanet e S.S.” është diku 5 km.

A.B.1 zëvendës komandani në Stacionin policor në Suharekë, më ka thënë se ka të dhëna se ka dru tjera për te “....” dhe mu ka lut a bon me i qit dy rojtar për me kqyr se prej “Staneve të S.S.” a ka rrugë tjetër për me u largu, unë i kam thënë po pastaj kam shti A. G. dhe A.Sh. me shku dhe me kqyrë se kah kanë shkuar apo ndoshta dikush kalon aty pari, këta të fundit më kanë lajmëruar se vija kaluese ka por drut i kanë gjete mirëpo traktora nuk kanë mujtë me gjete.

I akzuar shton edhe këtë se vendi ku janë prerë dhe janë vendosur dru si tek “....” dhe “te Stanet e S.S.” aty ka shumë rrugë alternative dhe me shku me vërtetu se kush i ka bërë të gjitha ato dallavere sipas mendimit këtu i akzuar duhet me qenë H.K.1 dhe Y. B. dhe jo unë dhe kolegët e mi.

I akzuar **H.K.**, nuk e pranon fajsinë dhe në pyetjen e mbrojtësit të tij av.O.Z.: ku ke qenë ditën kritike me datën 04.07.2015?

I akzuar tha se kam qenë në punë në fshatin , me të cilin teren edhe jam i ngarkuar si rojtar i pyllit. Orarni e punës kam filluar prej orës 08 të mëngjesit gjerë në ora 19:00, ku edhe në këtë kohë jam kthyer në shtëpi.

Pas mbarimit të orarit të punës, në ora 19:00 me telefon më ka thirre përgjegjësi S. J. , më ka thënë pregaditu se do të shkojmë në malet e , kanë ardhë më kanë marrë S. J., B.G., A.G. dhe H.B. me automjetin tonë zyrtar kemi shkuar në malet e Tereni imt i punës ka qenë fshati dhe përreth tij malet e fshatit Kam shkuaer te arat e “....”?

Av.O.Z.: a ke pas kontratë të punës?

I akzuar: po, për fshatin Kur kam shkuar në vendngjarje kamë parë dru të prera, te “....” kam parë dy tuba të drunjtëve të prerë. Nuk kamë hasur ndonjë traktor të mbushur me dru. Prej vendit të ngjarjes, jam kthye të nesërmen me 05 korrik 2015 në ora 19:00 të mbrëmjes. Drut të deponuara në vendin e quajtur “....” ato dru i kemi marrë, i kemi ngarkuar në disa traktora të kompanisë për momentin nuk e di të cilët bëjnë bartjen e druve. Dhe i kemi deponu në deponin e Kuvendit Komunal në fshatin

Prokurorja e shtetit: në pyetjen time të parashtruar në deklaraten e juaj të dhënë në prokurori se sa kohë keni qëndruar te “stanet e S.S.” ju jeni përgjigjur përafërisht 30 minuta, a keni lënë dikend te “... ” kur keni shkuar në drejtim te “stanet e S.S.”?

I akuzuari: unë, B.G., A.G. dhe H.B. kemi qenë me kerrin tonë zyrtar përgjegjësi S. J. na ka thënë me shku dhe me i gjete ato drutë tjera përveç këtyre tek “...”, jemi nisë na përpjetë taman kemi mbërri tek vendi “stanet e S.S.”, ka ardhë aty policia pas neve ku me policinë kanë edhe S.J.si përgjegjës dhe A.Sh., rojtari i pyjeve.

Ka qenë mengjezë kur kemi shku te “stanet e S.S.”?

Në pyetjen e prokurës:natën kur keni shku te vendi i ngjarjes “..” së bashku me shefin dhe rojtarët tjerë a ka shkuar dikush nga ju te “stani i S.S.” ose në atë vendin e tretë ku kanë qenë drut?

I akuzuari: gjerë në orët e mbrëmjes kemi qëndruar tek vendi “...” por të nesërmen në mëngjes jemi nisur në drejtim te vendi i quajtur te “stanet e S.S.”, ku i kemi gjete edhe drut tjera të tubuara në tre vende. Teren te “... dhe te “stanet e S.S.” Jo nuk i njofë mirë, kam qenë një herë para dy muajë ditëve nga se terreni ynë është në fshatin

Psh.: ju keni deklaruar se deri sa keni qenë në vendin e ngjarjes e keni takuar edhe H. K.1 i cili edhe i ka zbuluar keqbërësit - e ka zbuluar rastin ?

I akuzuari: po e kam takuar H.K.1 tek vendi “...”, dhe ai pastaj është larguar rreth orës 24:00. Ai diçka lidhur me rastin mua sme ka thenë, unë nuk flas me H.K.1.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.G., avokati N.Q.: a kanë qëndru gjatë gjithë kohës policët dhe çka kanë bërë aty në vendin e quajtur te “...”?

I akuzuari:te vendi i quajtur “...”, aty tanë natën kanë qëndru policët, kanë ardhur me ndërrime. Pa policinë skemi qëndruar asnjë minutë aty.

I akuzuari A.Sh. , në mbrojtjen e tij deklaroi se kamë dhënë një deklaraten pranë prokurorisë Themelore në Prizren me datën 30.shtator 2015, dhe qendroj në tërësi.

Marrëdhënjen e punës lidhur në Ministrin e mjedisit dhe planifikimit hapsinor në Prishtinë, dhe më kanë caktuar si kujdestar i natyrës në parkun nacional “.....”, ku edhe kam vendimin i cili ka afatin gjerë në vitin 2019 si kontratë pune.

Orarin e punës sipas kontratës dhe vendimit e kem 8 orë, por punën ndonjëherë e fillojmë në ora 06:00 të mëngjesit dhe mbaron gjerë në ora 17:00 e ndodhë edhe deri në ora 19:00 të mbrëmjes sipas nevojës, sipas nevojës nga se për çdo ditë udhtojë 10 a ma tepër kilometra me një drejtim kështu që është dashtë të qohem herët dhe të mbërri në punë.

Në pyetjen e avokatit S.H. mund të na sqaroni ditën kritike në ora sa ke filluar punën, dhe të na përshkruash lëvizjet e tua gjatë orarit të punës?

I akuzuari: atë ditë kam dalë në mëngjes prej shtëpisë nga ora 06:30 minuta prej fshatit , kam udhëtuar gjerë në fshatin në këmbë diku 5 km, kam mbërrë në fshatin dikund në ora 07:30 minuta, pastaj kam shkuar në drejtim të “.....”, vendi i quajtur “..... . ..”, kam kontrollu terenin nuk kam vërejte asgjë dhe jam kthye dhe jam lëvizur në drejtim të vendit “..... . ..” “..... . ..” dhe në pjesën e “.....”, në këto vende kam qëndruar gjerë në ora 16:00 minuta, pastaj kam vazhduar në drejtim të fshatit , në ato pjesë ku i përmenda nuk kam takuar askënd, mirëpo kur kam ardhë në fshatin tek shkolla, aty kam takuar automjetin e policisë me dy policë, jemi përshëndetur punën e tyre, e unë punën time. Tek qesmja e shkollës të fshatit aty jam ndal dhe e kam pastrua fytyrën dhe pjesën e trupit – teshave, dikund kah ora 16:30 më ka thirre drejtori H.D.1 dhe më ka pyet se ku je, unë e kam njoftuar atë që gjindem në fshatin D. tek shkolla.

Drejtori në telefon interesoju më tha A., kam informacion se në fshatin janë tuj hy dy traktora me dru, unë i thash në rregull do të interesohem dhe do të njoftojë në telefon. Në atë moment në pjesën e majtë të hyrjes për fshatin nga se ka shumë rrugë alternative kam qëndruar deri në 18:00 në atë kohë kam parë duke lëvizur dy xhipa civil të cilët ishin duke ardhur prej bjeshkës për në fshatin dhe për të lëvizur ma tepër, dhe kam vërejtur një traktor të ngarkuar me sanë.

Drejtorin e kam thirre me telefon por nuk ka pas qasje në rrjetë, edhe rojën H. K.1 i cili gjithashtu nuk ka pasë qasje në rrjetë.

Rreth orës 20:00 të mbrëmjes unë kam ardhur në shtëpi dhe më ka thirre në telefon S. J. përgjegjës i regjionit, më tha A. kam informacione prej policisë se kanë zanë dru të zbrazura në pyllë dhe duhet me shku me i rujtë dhe me i konfisku drut.

Te vendi “..... . ..”, kam mbërrë diku rreth orës 23:50 minuta me e automjetin e policisë së bashku me policë të Suharekës dhe dy të fshatit , S.A. dhe S.Sh. . Tek “..... . ..” aty kam takuar dy policë Sh.B. dhe M.K. të cilët kanë qenë në livadh, aty prezent ka qenë edhe Sedat Jemini me 4 rojet e regjionit dhe H.K.1 me një punëtor të parkut nacional.

Në livadhin tek vendi “..... . ..” aty kemi takuar 2 turra të zbrazur me dru, ku ato dru unë personalisht i kam fotografuar në mëngjes të nesërmen.

Në pyetjen e av.S.H.: a ke njohuri se përveç vendi tek “..... . ..” ka patur edhe turra tjera të druve të prera?

I akuzuari: unë njohuri nuk kam pas kurse S.J. ka qenë informuar për gjithqka çka ka ndodhë. H.K.1 aty nuk ka qendru me neve, aty e kam takuar atë është përshëndetur me mu ka ndejtur nja 20 minuta dhe është larguar nga ai vend.

Av.S.H. : këta persona që i përmende përveç H.K.1 sa kohë keni qëndru te “..... . ..”?

I akuzuari: aty kemi qëndruar gjerë në ora 05:00 të mëngjesit, unë i kam fotografuar ato dy turra dru të vendosura në atë livadh pastaj S.J. na tha që duhet me dalë dhe me kontrollu edhe vendet tjera, ku me automjetin “Niva” të komunës dhe me polici pra me dy automjete

kemi shkuar tek vendi i quajtur “..... . S.S.” Aty kemi hasur dy turra dru të zbrazura dhe një turrë tjetër, ku distanca ka qenë 200 m, pastaj nga vendi i quajtur “Stanet e S.S.” jemi kthye te “....”, duke mos mbetur asnjë person tek “stanet e S.S.”. Aty nuk kemi ndëgjuar asnjë zhurmë mirëpo dikund rreth orës 002:00 pas mesnate ka ardhur me automjet inspektori H. Z. më duket me një apo me dy polic nuk më kujtohet, H.Z. ka ardhë tek “....” dhe i ka marrë ata policët.

Se çka është bërë me me drut që kanë qenë tek “....”, i akuzuari tha se kanë ardhë dy traktora prej Suhareës të firmës tenderuese për bartjen e druve, për konfiskimin e tyre i kanë ngarkuar ato dru në dy traktora dhe i kanë qu në fshatin

Gjatë kohës kur kemi qëndruar tek “....”, sa i përket policëve, në ndërrimin e natës kanë qenë S.A. dhe S.Sh., kurse në ndërrimin e ditës kanë ardhë dy policë, emrat nuk ja di polic i Suhrekës, dhe tjetri nga fshati por me punë në fshatin, ata kanë qëndruar gjerë në ora 19:00, të datës 04.korrik 2015, gjerësa janë transferuar edhe turra e mramë.

Në petjen e anëtarit të trupit: po më intereson fati i druve te “Stanet e S.S.” çka u bo me ato dru, i akuzuari : ato janë transportu nga firma tenderuese, janë konfisku ato dru dhe janë bartur në fshatin në depo të Komunës.

Anëtari i trupit: a ka shteg tjetër prej staneve të “S.S.” apo patjertër duhet me kalu kah “....”?

I akuzuari: jo, ka edhe shtigje tjera, ka edhe rrugë alternative.

I akuzuari H.B., nuk e pranoj fajsinë për veprën penale e cila më vihet në barrë. Më 02.tetor 2015, kamë dhënë deklaraten në prokurori dhe në tërësi qëndrojë pranë asaj deklarate.

Unë si rojta pylli e mbulojë terrenin e quajtur “.....” përreth fshatit, dhe, dhe terreni im nuk hynë në terrenin e parkut nacional të Sharrit.

Në pyetjen e avokatit mbrojtës, gjatë tërë kohës deri sa keni qëndru mi rujtë drutë a keni pa ndonjë traktor i akuzuari: unë, S.J., H.K., B.G. dhe A.G., pas orës 23:00 kemi shkuar me automjetin “Niva” tek vendi “....” aty është përreth një livadh pronë private, kemi gjetë dy turra dru të shprazura truq në dy vende, në distancë shumë të hapur 2-3 m, kanë qenë dy traktora dru të shprazura por traktor aty nuk ka pas. Prej vendit “....” gjerë në fshatin ekzistojnë edhe rrugët tjera alnterative të kalueshme me mjete motorike – traktor etj.

Av: gjatë kohës deri sa kanë qëndruar policët Sh.B. dhe H.K. a keni komunikuar me ta?

I akuzuari: kemi qëndruar por nuk kemi komunikuar pasi që nuk kemi haspru traktorat.

Të nesërmen se kush e ka bërë ngarkimin e druve tha se unë, gjatë tërë kohës kam qëndruar në atë vend kur kanë ardhë kompania, i ka ngarkuar ato dru me traktor dy traktora dhe kanë bartë 4-5 herë prej atij vendi për në fshatin në depot e Kuvendit, dhe asnjë minut pa një patrollë policore nuk kemi qenë. Unë kamë qenë ti te “stanete e S.S.”.

Prej vendit “Stanet e S.S.”, “...” për të arritur në fshatin nuk është e vetmja rrugë kaluese, ka edhe rrugë tjera alternative.

Në pyetjen e KTGJ: gjatë tërë kohës që ke qëndruar si tek vendi “...” ashtu edhe te vendi “stanet e S.S.” a keni vërejtur ndonjë traktor apo lëvizjesh traktorësh?

I akuzuari: jo, nuk kam vërejtur.

I akuzuari A.G., në mbrojtjen e tij deklaroj kam dhënë deklaraten në prokurori dhe qëndrojë në tërë pranë asaj deklarate. pas orarit të punës me telefon më ka thirrë S.J. me telefon, më ka thënë pregaditu vishe uniformën meqë unë janë rojtar në rajonin e ka ardhë B.G. te unë në shtëpi kemi shku e kemi marrë H.B. në , H.K. në dhe na ka thënë se më ka njoftu H. dhe policia që janë disa tuba druve te “...” dhe tek vendi i “stanet e S.S.”, kemi shku në mbrëmje dikund rreth orës 22:30 minuta, në fillim te “...” kemi gjete 2 tuba dru, dy policë dhe dy rojtar dhe aty kemi qëndruar tërë natën gjerë të nesërmit në mëngjes, pastaj fillimisht unë së bashku me B.G., H.K., H.B., aty kemi gjetur edhe 3 tuba dru të prera, aty kemi qëndruar gjysëm ore e pastaj jemi kthyer te “...”, përveç druve të tubuara dhe të prera, aty kemi takuar dy policë dhe dy rojtar tjetër e asgjë tjetër, as edhe mjete tjera motorike.

Në marrëdhënje pune, jamë përafërsisht 9 vite.

Në pyetjen e prokurorës, në momentin kur jeni nisë te “stanet e S.S.ylës” a e keni lëndë dikend poshtë te “...”. I akuzuari tha se te “...” kanë mbete S.J., A.Sh. dhe dy polic.

Kur jemi kthye prej “Stanet e S.S.”, te “...” persona tjerë nuk kemi gjetë, nga se në atë vend askush nuk ka mbetur por kemi shkuar të gjithë te “stanet e S.S.”.

Avokati S.H.: te vendi “Stanet e S.S.” kur keni shkue pas sa kohe aty ka arritur edhe A.Sh., S.J. dhe dy policët?

I akuzuari. kanë ardhur pas një kohe shumë të shkurtër diku rreth 15 minuta më duket se tanë kohën ka qëndruar rojtari dhe përgjegjës i rajonit parku kombëtar “Sharri”.

Nuk e ndiejë vehten fajtor sepse me asnjë veprim nuk kam kryer veprën penale për të cilën akuzohem.

I akuzuari B.G., në mbrojtjen e tij deklaroj se nuk e pranon fajsinë, duke shtuar se më dt.02.10.2015, kam dhënë deklaraten në prokurori dhe qëndrojë në tërësi pranë asaj deklarate.

Jam i ngarkuar me punë në rajonin 2 ku përfshinë fshatrat , , , deri te lapidarit i partizanit.

Me datë 03.korrik 2015, kamë shkue në fshatin , më ka ftuar me telefon përgjegjësi S.J. për me shku në fshatin dhe atje kam mbërri dikund pas orës 22, Kur jemi nisur për

me shku nuk kemi pasur mjet drite dhe gjerë në momentin kur kemi mbërri në fshatin , nuk kamë bisedu me dikend në telefon.

Kur kemi mbërri në vend nuk kamë pa traktora, nuk kam parë asgjë, përpos 2 tubave dru.

Në pyetjen PSH: deri sa keni punu si roje pylli a ka pas ndonjë rast tjetër me iu thirre dhe me ju thënë se hajde se ka ndodhë një rast?

I akuzuari: po, ka patur raste në fshatin , gjithmonë përgjegjësi.

Anëtari i trupit: kur ke marrë thirrje për me shku te “....” a ka përmend dikush se aty ka edhe traktora?

I akuzuari: jo, përveç dy tubave të druve.

Në bazë të deklaratve të dëshmitarve e psaqërisht dëshmitarit H. K.1 , nga mbrojtja e të akuzuarve dhe administrimit të provave , në tërësi u vertue se me date 04.korrik 2015, në mes të ores 05:00 dhe 08:10 minuta, i pandehuri S.J. në cilësi të personit zyrtar edhe atë përgjegjës i Njësisë komunale për pylltari komunale në suharekë, të pandehurit H.K. , H.B. , A.G. , dhe B.G. në cilësi të personit zyrtar, dhe ate roje pyelli dhe A.Sh. në cilësin e personit zyrtar kujdestar (roje) i natyrës, duke e shfrytëzuar detyrën e tyre zyrtare, si bashkëkryerës nuk i përmbushi detyrat zyrtare të tyre me qëllim të përfimit të çfarëdo dobie për personin tjetër dhe shkaktimin e demit një personi tjetër dhe me atë rastë shkelin me dashje ligjin lidhur me detyrat e tyre zyrtare, në atë mënyrë që të pandehurit duke u larguar nga vendi i ngjarjes “...”, e cila administrohet nga Drejtoria për pylltari, bujqësi dhe zhvillim rural i Komunës së Suharekës, mundësojnë që keqberësit Xh.D. dhe R.H. hajdari, që të dy nga fshati , Komuna e Suharekës, ti largojnë traktorat e tyre të tipit “Rakovica” të ngarkuar me dru të prera në mënyrë ilegale në bjeshkët e fshatit e cila administrohet nga parku kombëtar “sharri”, nëpërmes rrugës së vetme që kalon në afërsi të “....” traktor këta të clët policia së bashku me dëshmitarin H.K.1 i kishte identifikuar dhe fotografuar me date 03.korrik 2015, me ç’ rast parku komëbtar “sharri” i është shkaktuar dëm në vlerësn e druve të prera të ahut.

Gjëndja faktike

I akuzuari S.J. është përgjegjës i Njësisë Komunale për pylltari, H.K.1 roje pylli, A.Sh.kujdestar parku, H.B. , A.G. dhe B.G. roje pylli, që i perket rajonit për pylltari dhe parkut nacional Sharri në Suharekë dhe të gjith në cilësin e përsoneve zyrtar.

Edhe pse të akuzuarit kanë qenë jasht orarit të punës, të gjithë ata janë informu nga eprori i tyre që të shkojnë dhe të kujdesën për drutë e prera, para se arto dru të vendosen në deponë në fshati

Në bazë të provave materiale dhe deshmive të dëshmitarve , është vertetuar se drutë janë prer në teritorin e cila administrohet nga parku kombëtar “Sharri” në teritorin e komunës së Suharekës dhe se traktoret janë fshehur në teritorin jasht oparkut kombëtar , në terenin që

administrohet nga drejtoria për bujqësi dhe zhvillim rurla të komunës së Suharekës-agjensioni pyjor.

Më datën 03.07.2017, rreth orës 18:00, Drejtoria e Parkut Kombëtar “Malet e Sharrit” i kanë informuar puntoret, rojet e parkut H.K.1 dhe T.L. se në parkun kombëtar “Sharri”, tek vendi i quajtur “..... . ..” janë duke zbritur pesë traktor me drunjë, rojet e pyllit i kanë vrejtur traktoret duke zbritur rrugës të ngarkuar me drunjë, ku të njëjtit i kanë vezhguar në largësi me dylbi dhe i kanë identifikuar të dyshuarit. Rojet e parkut e kanë informuar drejtorin, poashtu është informuar edhe policia e cila së bashku me rojet e parkut kanë dalë në vendin e ngjarjes, ku aty kanë hasur dy traktor, një i llojit “Shtore” ngjyrë e kuqe, kurse tjetëri “Rakovicë”, ngjyrë e kalterit, të dyshuarit pronarë të traktorve i kanë zbrizur drutë dhe kanë hikur nga vendi i ngjarjes, ku supas rojeve të pyllit, të parkut, vetëm traktori “Rakovica” ka mbetur në vendin e ngjarjes, tek vendi i quajtur “.... . ..” . Krejtë kjo sipas rojeve të parkut H.K.1 dhe T.L. , të cilët kanë bërë vlerësimin e drunjëve dhe perafersisht masa drurore të prera ka qenë 25 metra, drunjë të njoma ahu , të cilët pastaj kanë njoftuar policinë e cila ka bërë sigurimin e druve dhe traktorit.

I pakontestuar është fakti se nga informatat e mbledhura nga terreni se disa keqberës ditën kritike kanë qenë në pyll për të pre dru tek vendi i quajtur “..... . ..” të cilët kur kanë vrejtur rojet e parkut e Parkut Nacional dhe policinë, të dyshuarit kanë arritur ti zbrazin drutë nga traktoret e tyre dhe të hikin nga vendi i ngjarjes. Dy traktoret të llojit “Rakovica ...-..”, me ngjyrë të kalterit , njeri me kabinë, pa xhama të kabinës dhe tjetri pa kabinë , keqbërësit i kanë lenë në vendin e ngjarjes dhe kanë hikur duke e shfrytëzuar kohën dhe neglizhencën e të akuzuarve “rojtave të pyllit” dhe kanë arritur ti largojnë traktoret e tyre nga vendi i ngjarjes.

Në bazë të fotografiave të bëra nga vendi i ngjarjes dhe atyre të bëra më dt.10.07.2015 nga Njësi i Hetimeve, është arritur në përfundim se traktori i llojit “Rakovica” ... ”, ngjyrë e kalterit, pa kabinë ka qenë pronë e të dyshuarit Xh.D., kurse traktori , ngjyrë e kalterit, me kabinë, pa xhama të kabinës, ka qenë pronë e të dyshuarit M.H. , të cilët traktor nga të dyshuarit janë larguar nga vendi i ngjarjes.

Në bazë të dhënave nga Drejtoria për administrimin e parkut kombëtar “Sharri” lidhur me rastin e datës 03 dhe 04.korrik 2015 që kanë të bëjnë me prerjen ilegale të tyre në teritorin e parkut kombëtar “Sharri” dhe lejin e keqbërësve për ti larguar traktorat e zenë me dru të prera ilegale rrjedhë se me datën 03.07.2015 në zonën tek vendi i quajtur “..... . ..” të rajonit të fshatit , në kuadër të teritorit parku kombëtar “Sharri” në mënyrë ilegale janë prerë dru të ahut nga personat e fshatit me 5 traktora rastin të cilin e ka identifikuar dhe lajmëruar H.K.1 rojtari në drejtorinë e parkut kombëtar “sharri”. Sasia e masës drurore të prera në mënyrë ilegale ka qenë 10 m³ dhe vlerësimi është bërë me matjen e drugve në rimorkio të traktorëve, pasi që shumica e masës drurore që është prerë nga keqbërësit ka qenë e ngarkuar me këto mjete të transportit, (nga 2 m³ për traktor , që gjithsejtë ka qenë 5 traktor me rimorkio).

Nga fotografit e shkresave të lëndës është vërtetuar se me datën 03.07.2015 janë zënë dru e prera në mënyrë ilegale dhe të deponuara apo të paluara, pastaj edhe të shpërndara si dhe traktorat të cilët edhe janë gjetur në vendin e ngjarjes.

Tre dëshmitaret: H.K.1, I.S. dhe Sh.B. në prokurori dhe në shqyrtimin kryesor kanë deklaruar në mënyrë identike.

Gjëndja faktike është vertetuar në bazë të dëshmisë së dëshmitarit H.K.1 të dhënë si në prokurori dhe në shqyrtimin kryesor, se më 03 korrik 2015 rreth ores 17.52 min, se ka vrejtr pesë traktora duke dalur prej vendirt të quajtur “..... . ..” që gjindet ne admnistrimin e parkut kombëtar. Më tëvrejtur traktoart rreth opres 18:00 ka lajmeriuar Drejtorin Rajonale të Policisë në Prizren, pikërisht rreshterin H.H. si dhe Stacionin Policor në Suharek, ka biseduar me policin B.Z. dhe ka kerkuar nga keta policë që të asistojnë rreth konfiskimi të druve. Më të marrë lamin, plicet kanë reaguat shpejtë dhe kanë shkuar në vendin e ngjkarjës, mirëpo demtuesit i kanë hetuar ardhjen e pocëve , shpejt i kanë zbazur traktoret dhe i kanë fshehur , mirëpo rreth ores 19:53 minuta jo larg vendit të ngjarjes kanë hasur një traktor Rakovicë , ngjyrë të kaltert me 65 kaë fuqi, pa targa regjistrimi, pastaj ka takuar edhe policët e patrullës Sh.B., R.E., dhe I.S. ku kanë fotografuar traktorin i cili ka qenë i ngarkuar me dru, por i braktisur. Tek vendi i quajtur “.... . ..” kanë gjetur edhe dy turra të zbrazura, pej traktorit ndërsa 250 m, më largë edhe dy turra me dru, në pyll kanë hasur në dy traktora e zbrazur, njeni ka qenë “Rakovic” me ngjyrë të kaltrët, ndërsa tjetri, “Uniman” dhe këta dy traktora nuk kanë mujtë me i fotografu nga se kanë vrapuar për ti zënë edhe dy traktora tjerë të cilët kanë qenë në lëvizje. Kanë bërë fotoghrafimin e druve të zbrazura dhe kanë vazhduar ti kërkojnë edhe dy traktora tjerë tek vendi i quajtur “... . ..”,ku në atë vend kanë hasur edhe dy turra me dru i kanë fotografuar dhe jo largë druve dhe një traktor “Rakovic” me ngjyrë të kaltërt, të njejtin e kanë fotografuar së bashku me policët.

Sipas dëshmitarit rreth orës 21:00 në vendin e ngjarjes kanë shkuar edhe përgjegjësit e Agjencionit pyjor të Kosovës, drejtoria në Suharekë, S.J., H.B., H.K., A.G. dhe B. G. nga se drejtori Xh.K. ka thënë që drut nuk mund të transportohen për sot dhe do ti qojë punëtorët e vet dhe ata do ti ruajnë tërë natën nga se janë të armatosur. Tek vendi i ngjarjes kanë qenë edhe policët dhe dëshmitari i ka thënë S.J. se ku janë të vendosur traktorët dhe ku janë drut dhe diku rreth orës 23:40 minuta, tek vendi i ngjarjes ka shkuar polici H.F. së bashku me një koleg të tij dhe ka sjellur patrullën e policisë e cila është dashur të qëndrojë në vednin e ngjarjes, S.A. e S.Sh. dhe me ta ka qenë kujdestari i parkut nacional, A.Sh. dhe dëshmitari H.K.1 ia ka dorëzuar detyrën A.Sh. dhe punëtorve të agjencionit pyjor të Kosovës, rojeve të pyllit, duke u treguar se ku janë traktorat dhe ku janë drut ndërsa policiaia ka dorëzuar detyrën kolegëve të tyre që kanë ardhë ti zavendësojnë. Traktorin e parë të cilin e ka fotografuar dëshmitari në vednin e quajtur “..... . ..” është pronë e S./R./H., nga fshati , Komuina e Suharekës, ndërsa traktorët tjerë që kanë qenë 250 m, më largë prej vendit “.... . ..” kanë qenë pronës e S./R./H. , nga fshati , ndërsa tjetri pronë e H./A./D. nga fshati , ndërsa traktori që është gjetur në afërsi te “.... . ..” ka qenë pronë e Xh.D. , nga fshati , Komuna e Suharekës. Detyrën ia ka dorëzuar A.Sh. sepse ai ka qenë kujdestar parku dhe përgjegjës për atë teren, prej Kaqanikut deri te “..... . ..”, nuk ka qëndruar në vendin e ngjarjes, pasi që e kishte kryer orarin e punës. Drut janë prerë në vendin e quajtur “..... . ..” që bie nën administrimin e parkut nacional.

Sipas këtij dëshmitari, i pari traktor që e kanë has dhe vërtetu me patrullën e policisë ka qenë i mëshëfur afër vendit të ashtuquajtur “..... . ..”, ky vend ku ka qenë traktori i parë

është nën administrimin e parkut kombëtar “Sharri”, por vendi ku është mëshefur traktori është pronë private. Dy traktorët tjerë që i kanë gjetur pas traktorit të parë, drutë i kanë zbrazë dhe janë mshefur me traktor në largësi 250 – 300 m. prej druve të zbrazura. Ajo pjesë ku janë mshefur traktorët dhe vendi ku janë të gjetur të zbrazura drutë ajo është nën menagjimin e Agjencionit të pyjeve të Kosovës. Në momentin kur i kanë hasur në këta dru të prerë dhe traktorët e braktisur, fillimisht kanë kërkuar ndihmë prej policisë rregjionale prej H.H., polic në policinë e Lubizhdës në rregjion, dhe policit në stacionit të Suharekës B. Z., ka ardhur patrolla e policisë Sh.B., I.S. dhe R.E. dhe kemi bërë fotografimin e drujëve të traktorëve. Te “...” janë bërë fotografimit e dy turave dru dhe një traktori “Rakovicë”.

Pos policisë, deshmitari ka lajmëruar Xh.K., drejtor për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural në Komunën e Suharekës, i cili i është përgjegjur “ nuk mundem sonte me ardhë se është vonë” dhe i ka qua punëtorët e vetë në ora 21:00 kanë ardh rojet e pyllit, që janë në kuadër të komunës kanë ardh me përgjegjësën e tyre S.J., H.B., H.K., A.G. dhe B.G. i kemi informue se ku janë traktorat. Gojarisht i informova për traktorët e mshfura dhe drujtë e zbrazura. Deshmitari ka qëndruar aty së bashku me policinë para se ti njoftoj dhe pasi ata kanë ardhur në vendin e ngjarjes. Kanë qëndrua deri në ora 23:40 atëherë është bërë ndërrimi i policisë të cilët i ka prue H.F. dhe F.S. në ndërrimin e policisë, që të dytë policë në stacionin policior në Suharekë. Policët ishin S.A. dhe S.Sh..

Pasi që e ka lajmëru policinë, ka lajmëruar edhe shefin për mbrojtjen e pyjeve kombëtare parkut nacional “Sharri” N.K.. Përndryshe ky deshmitar në parkun kombëtar “Sharri” e ka përgjegjësi në terenin e Mushtishtit, prej kryqit afër vendit ku janë pre drujtë deri në malet e Kabashit, deri tek vendi “....”.

Masa e druve të prera saktësisht ka qenë 5 traktora me afër 20 m kub, ka qenë afër masës së drunjtëve të prera dhe gjithë ajo masë e drunjtëve ka qenë e prerë pa leje. Vendi i prerjes ka qenë te proni i “Karagjës”, dhe kjo prerje është bërë në parkun kombëtar “Shari”.

Traktorat me dru janë hetua në ora 17:52 minuta, kur ai i ka vërejtur dhe vëzhgu traktorat dhe drunjtë e prera, por drunjtë janë prerë para kësaj kohe.

Lidhur me identifikimin, deshmitari ka arritur ti identifikoj se kush është kryerësi apo prerësi i këtyre drunjtëve, sipas tij ata kanë qenë, i pari traktor që është hasur në vendin të cilën e ceka më lartë është Xh./Z./D. nga fsh. , ky i ka pre drunjtë dhe traktori është i tij. Ka qenë edhe një traktorë i markës “Shtore”. Ndaj tyre nuk është duke shtuar fletëparaqitje nga se pa fole me personin e pa hasur atë nuk mund të ushtrohet fletëparaqitje.

Drejtorin, Xh.K e ka ftuar, por më nuk i kujtohet në ora sa, për arsye se Drejtoria e parkut kombëtar “Sharri” kanë marrëveshje me komunën me shkrim që drunjtë që konfiskohen. Traktorat në vendin e ngjarjes kanë qenë deri në ora 23:40, pastaj ka shkuar në shtëpi dhe pas kësaj nuk ka qenë në ngjarje. Esht takuar me S.J. në vendin e ngjarjes dhe i katreguar vendin se ku gjidnen drut dhe traktorat, ora ka qenë 21:00. Drut janë transportuar nga vendi në ora 14:00 pas dite, në vendin e deponimit në fshatin , ku me ate deponi administron Komuna e Suharekës.

S.J. ka qëndruar me ta deri në ora 23:45 minuta. Prej “..... ..” dhe te “... . ..”, prej vendit të prerjes e deri te vendi i zbrazjes së druve, përafërsisht ka 3 km, dhe aty mundet me ardhë me traktor për një orë. S.J. e njuhë si shef apo përgjegjës i rojeve të pyellit. H. K. ka shkuar me grupin e vet me S.J. në vendin e ngjarjes te “... . ..” pik takimi aty ka qenë me ata H.K., drut i ka pa në vendin e ngjarjes, por traktorin jo, i njejtë në atë vend ka ardhë në ora 21:00 dhe ka qëndruar gjerë në ora 23:45 minuta, kur deshmitari ka mbaruar orarin e punës dhe ka shku në shtëpi .

Në “malet e Kabashit” nuk i ka pa prerësit e druve, por kur ka ardhë në vendin kur janë pre dru, aty e ka pa Xh./Z./ D. nga fshati , H./A./D. me traktor “unimal” prodhimi gjerman dhe S./R./H. nga , i fundit ka qenë R./S./H., nga fshati

Gjëndja faktike është vertetur edhe në bazë të deshmitarit I.S. , i cili natën kritike ka marrë njoftimin se nënstationi policor në Mushtisht ka nevojë për asistim ngase në bjeshket e fshatit janë parë disa traktor me dru të prer në mënyrë ilegale, ka shkuar në vendin e ngjarjes së bashku me R.E. dhe Sh.B. . Në afersi të ngjarjes kanë ndaluar automjetin dhe kanë vazhduar në këmbë . Tek vendi i ngjarjes kanë takuar H.K. së bashku me një koleg të tij dhe ata kanë treguar se se kanë hetuar disa traktor që levizin neper mmalet e fshatit të cilat janë të ngarkua me dru të cilat janë prer në mënyrë ilegale. Gjatë rruges neper male, ata në afersi të vendi i quajtur “..... . ..” kanë vrejtur një traktor “Rakovicë” i ngarkuar me dru, i parkuar jashtë rruges, i fshehur në pyll, i fotografuar nga H.K. . Pak më posht kanë verjtur edhe dy tuba me dru , kanë shkuar pastaj të “... . ..” ku kaparë edhe një turrë me dru të prera , ndërsa 200 metra më larg ka vrejtur një traktor i ngarkuar me dru po i filluar të shkarkohet, dhe të gjith këta traktor kanë qenë të braktisur nga pronaret e tyre apo demtuesit.

Natën kritike pasi që është caktu për të shkuar në vendin e ngjarjes , ka pa vetëm dy traktora si dhe grumbuj drujsh.

Sipas deklaratës së këtij deshmitari të dhënë në shqyrtimin kryesor është vertetur se natën kritike në teren nuk e ka takuar S.J., në vendin e ngjarjes ka mbërrë në ora 18:00. Sa i përket traktorave njëri ka qenë në vendin e ashtuquajtur mbi stanet e “..... ..” e tipit të markës “Rakovic”, me kabinë dhe me rimorkio i ngarkuar me druajtë dhe i mbuluar me disa dega dhe gjethe, kurse tjetri traktor gjithashtu i markës “Rakovic” ka kabinë i gjysmë ngarkuar me druajt, është gjetur në vendin e ashtuquajtur “... . ..”, gjersa kanë ardhur patrullat tjetër këta traktora kanë qenë në gjendje të njejtë, gjera ka ardhur patrulla tjetër e policisë..

Sa i përket sigurimin e traktorëve, traktori i cili ka qenë naltë, vetëm është fotografua, për arsye se kemi qenë në kërkim të traktorëve tjerë, ndërsa traktori i dytë është gjetur i fundit gjysmë i ngarkuar ku te ky traktor edhe kanë qëndruar. Këtu të akuzuarin H.B. nuk e kanë takuar në vendin e ngjarjes. Deri te “... . ..” e gjerë te traktori i gjysëm ngarkum distanca ka qenë rrethe 300 m, i futur në mal, kurse traktori tjetër apo njëri me tjetrin kanë qenë distanca 3 km – 4 km. Dershmitari natën kritike nuk e ka vërejtur A.G. .

Gjendja faktike është vërtetur gjithashtu edhe në bazë të deklaratës së deshmitarit Sh.B., polic në policin e Kosovës, i caktuar në detyrat e punës në nënstationin e Policisë në fshatin në bazë të cilit duke patrolluar së bashku me kolegun e tij M.K. , pikërisht në atë ditë

rreth orës 16:00 në afërsi të fshatit kanë takuar rojen e pyllit A.Sh. , i cili është roje në parkun nacional, të cilët e kanë pyetur atë se a ka ndonjë problem, i është përgjigjur se çdo gjë është në rregull.Rreth orës 18:06 minuta, kolegu i tij M.K. ka marrë një njoftim nga komandati i nënstacionit Policor i cili ka njoftuar se në bjeshkët e fshatit janë duke u bartur 6 traktora me dru,dhe me të marrë kumtimin janë nisur drejtë maleve të për në vendin e quajtur “te shtëpija e” ku janë takuar me patrullën e Stacionit Policor “Bravo baza sektori 1” në Suharekë ku për shkak të terrenit të pa përshtatshëm nuk kanë mundur të udhëtojnë me automjetin “golf” janë marrë vesh që M.K. të qëndrojë në automjetin “Golf”, të qëndrojë në atë pjesë të rrugës nga se e vetmja rrugë nga e cila duhet të kalojnë traktorat ishte rruga ku janë ndalur me automjetin “Golf” nga se nuk ka rrugë tjetër alternative dhe me automjetin “Nisan” janë nisur së bashku me kolegët e tij R.E. dhe I.S. të cilët shpesh herë kanë kontaktuar me komandatin sepse për te terreni ka qenë i panjohur i cili i ka udhëzuar se të shkojnë deri tek “stanet e” ku aty në afërsi të staneve kanë parë 3 grumbujë me dru të zbarkuar në anën e majtë të rrugës, kanë njoftuar komandatin se kanë gjetur dru por jo edhe traktorat. Kanë vazhduar rrugën për në “Stanet e” mirëpo janë kthyer dhe rrugës kanë takuar kuiuadestarin e parkut nacional H.K.1. Me një person tjetër me automjetin e tyre zyrtar të parkut nacional ku dëshmitari H.k.1 i ka treguar vendin ku është traktori i fshehur, e kanë gjetur traktorin me ngjyrë të kaltërt me kabinë dhe ka qenë i tipit “Raikovica ..” të cilin traktor e ka fotografuar H.K.1e i cili ka qenë i mbushur me dru me rimorkio me masën përafërsisht 5 m2 . Dëshmitari H.K.1 u ka treguar që edhe dy traktora me dru janë fshehur tek vendi i quajtur “....” dhe për këtë faktë kanë njoftuar edhe komandantin e nënstacionit dhe me lejen e tij janë nisur në drejtim te vendi “...” ku aty kanë gjetur 3 grumbujë tjerë me dru të zbarkuar, përafërisht 15 m2 por nuk kanë parë traktor,m irëpo kanë vërejtur gjurmët e një traktori, ky dëshmitarë ka qëndruar tek “....” për ti siguruar automjetin dhe drut ndërsa H.K.1 së bashku me dy kolegët e tij kanë ecur drejtë gjurmëve të traktorit dhe pasi janë kthyer i kanë treguar se diku 300 m, nga vendi ku ka qëndruar në brendësi në mal, kanë gjetur edhe një traktor të tipit “Rakovica ..” pa kabinë i ngjyrës së kaltërt në rimorkion e të cilin ka pasur 1m2 dru. Sipas këtij dëshmitari diku rrethës orës 22:20-45 minuta, janë kthyer nga terreni me aujtomjetin e policisë, ka ardhë edhe H.K.1 dhe sipas dëshmitarit, S.J. përgjegjës i Agjencionit pyjor i ka thënë H.K.1 që edhe ai duhet të qëndrojë me ta, mirëpo H.K.1 i është përgjigjur se është shumë i lodhur nga se prej orës 05:00 të mëngjesit është në teren-punë. Gjithashtu sipas këtij dëshmitari S.J. dhe katër rojet e Agjencionit pyjor të Kosovës, kanë shkuar në vendin e ngjarjes në ora 22:45 minuta, të cilëve ky dëshmitarë u ka treguar se kanë hasur në traktora me dru dhe i kemi treguar se i kemi fotografuar.

Gjykata gjithashtu duke iu referuar deshmisë së këtij deshmitari, se kur kanë arritur në vendin e ngjarjes kanë vërejtur raktora, një traktor e kanë pa një nuk e kanë pa, traktorin e parë e kanë parë në vendin afër stanit të “..... ..” dhe është fotografuar traktori, i ngjyrës së kaltërt i markës “Rakovicë” me kabinë dhe me rimorkio dhe i ngarkuar me dru dhe është fotografuar. Në vendin e ngjarjes kanë shkuar puntorët për Agjencionit pyjor të Kosovës për Komunën e Suharekës dhe punëtorët e Parkut nacional “Sharri A. Sh. përgjegjës i pylltarisë, S.J., B.G., A.G., H.K., H.B. dhe A.Sh., këta janë njoftuar njoftuar me faktin se në teren janë dy traktorë, nga deshmitari dhe nga H.K.1, përgjegjësi është njoftuar shumë mirë, të gjithë të akuzuarit kanë qenë prezent në momentin kur e kanë lëshuar vendin e ngjarje kur ky deshmitar së bashku me koleget e vet – policët janë larguar nga vendi i ngjarjes.

Duke iu referuar deshmive të këtyre tre deshmitarve dhe deshmitarit Xh.K., më padysim është vertetuar se në vendin e ngjarjes kanë parë traktora të ngarkuar me dru të prera ilegalisht nga keqberësit e të fshehur në male, kanë pa turra me drunjë të prer, numri i traktorev ka qenë dy, janë fotografuar drut dhe traktorat, dhe nga gjithë kjo situat, rrezullton se të pandehurit si persona zyrtar të Njësisë Komunale për pylltari për komunen e Suharekës, të gjithë kanë patur autorizim dhe detyrë që sipas urdhëresave të eprorit të tyre të kujdesen dhe ty ruajnë atë, e pikësëpari në bazë të kontrates së punës të dhenë nga H.D.1 , kët detyr e ka patur i akuzuari A.Sh., ndersa në bazë të deklarates së deshmitarit Xh.K., S.J. ka pas për obligim koordinimin e punëve, në rast nevoje ka qenë i obliguar që të dalë edhe në vend të ngjarjes dhe se A.B.1 është ankuar se S.J. ka ardhur shumë vonë dhe më janë rrezikuar dy policë që tëlët kanë bërë sigurimin e druve atje, dhe në bazë të këtij deshmitari Xh. K.j, kur ka shkuar në këtë drejtori, S.J. e ka gjete si përgjegjës në sektorin e pylltarisë në Suharekë, në bazë të njohurive që ka, përgjegjësi i pylltarisë i koordinon punët me stafin e pylltarisë, duke përfshirë teknikun dhe rojet e pyllit, të cilët kanë për detyrë mbrojtjen e pyjeve nga prerjet ilegale nga zjarret nga uzurpimet etj, dhe në bazë të njohurive që ky deshmitar posedonë, ky, shefi dhe stafi i pylltarisë paguhen për 8 orë pune në ditë, në bazë të ligjeve në fuqi përgjegjësinë e kanë 24 orë, dhe si drejtor i ka thirre në përgjegjësi 24 orë, kur ka pas nevojë.

S.J. ka pas për obligim koordinimin e punëve, në rast nevoje ka qenë i obliguar që të dalë edhe në vend të ngjarjes.

Githashtu në bazë së deshmisë së këtij deshmitari, dëmi që është shkaktua në parkun nacional apo në agjencionin e pyjeve është përgjegjës S.J. ka qenë në momentin kur e ka marrë telefonatën nga A.B.1 edhe pse nuk ka ditur se ku janë drut dhe në cilin vend janë pre, por të nesërmen kur është taku me shefin e pylltarisë S.J. i cili e ka njoftu se drutë kinse kanë qenë të prerë në parkun nacional e cila nuk është përgjegjësia e tyre, por që vendi ku janë shkarkuar drut ka qenë vend i territorit të pylltarisë, te Agjencioni për pylltari, të cilën e kanë përgjegjësi që ta ruajnë.

Sipa deshmitarit A.B.1 është ankuar se S.J. ka ardhur shumë vonë dhe më janë rrezikuar dy policë që tëlët kanë bërë sigurimin e druve atje.

Vepra penale keqperdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar neni 422 par.1 të KP

*Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj qfardo dobie për vete ose për personin tjetër apo që i shkakton dem përsonit tjetër ose seriozisht ti shkel të drejtat e plërsonit tjetër, denohet

Të pandehurit në momentin e kryerjës së veprës penale kan patur cilësin e përsonit zyrtar, i akuzuari S.J. është përgjegjës i Njësisë Komunale për pylltari, H.K. roje pylli, A.Sh. kujdestar parku, H.B., A.G. dhe B.G.roje pylli, që i perket rajonit për pylltari dhe parkut nacional Sharri në Suharekë, si të pinësuar në institucione publike dhe cilësia e përsonit zyrtar është e percajktuar me Ligj.

Të gjith të akuzuarit i kanë tejkaluar detyrat e punës dhe autorizimet që kanë patur ata kanë deshtuar dhe nuk kanë përmbushur detyrat e tyre zyrtare, në atë drejtim që kanë patur

për detyr ti ruajnë drut e prera ilegalisht dhe traktoret qoft të ngarkuar me dru ose të shprazur, duke lejuar largimin e traktorve dhe keqbersve të largohen nga vendi i ngjarjes .

Me veprimet e tyre të gjithë të akuzuarit kanë patur për qellim të shkakimit të dëmit Parkut Nacional “Sharri”, në lartësin e druve të prera.

Më rastin e vendosjes në këtë qestje penale, trupi gjykues në tërsi u besoj deshmive të deshmitarve H.K.1 Ismet S./Sh./B. dhe Xh.K. sepse deshmit e tyre ishin bindëse në drejtim të ndriqimit të rastit të ndodhur ditën kritike qoft në malet e teritorit të komunës së Suharekes, e sidomos në teritorin e maleve të Parkut Nacional “Sharrit”, të cilët në mënyrë identike trguan rrjedhjen e ngjarjes duke filluar prej momentit kur kanë kuptuar për prerjen e palgshme të druve nga keqberësit, vendin ku ato dru janë pre, vnedi i grumbullimit, shprazja nga traktoret, vendi ku janë gjetur dy traktoret e brajktisur, fotografimi i druve dhe traktorve e gjerë të neglezhenca mos angazhimi i të gjithë të akuzuarve për parandalimin e keqbersve e gjerë të kapja dhe ndalimi i tyre.

Mbrojtësi i të akuzuarit S.J., avokatja N.H. fjalën përfundimtare gjykatës i aka deponuar me shkrim kun ë fillim ka theksuar se gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar asnjë prove relevante teza e aktakuzës së prokurorit të shtetit, me të cilën të mbrojturit tim i veht në barrë vepra penale keqpërdorimi apo iautoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KP dhe propozojë që gjykata të akuzuarin S.J. në mungesë të provave nëpajtim me nenin 364 par.1 nënpar.1.3 të KPP, ta liron nga aktakuza.

Mbrojtësi i të akuzuarit H.K., avokati O.Z. fjalën përfundimtare gjykatës i aka deponuar me shkrim i propozojë gjykatës që të akuzuarin H.K., ta lirojë nga përgjegjësia penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.Sh. avokati S.H. në fillim ka theksuar se aktakuza e Prokurorisë themeloe në Prizren është ngritur në bazë të fajsisë së supozuar, se i mbrojturi im së bashku me të akuzuarit tjerë në bashkëkryerje kanë krye veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar mirëpo sipas mbrojtësit me asnjë prove të vetme nuk është vërtetuar fakti se nëveprimet e të mbrojturit të tij paraqesin elementet e veprës penale për të cilën akuzohet dhe kërkon nga gjykata që në kuptim të nenit 364 par.1 p.1.3 të KPP, të merr aktgjykim lirues, nga se nuk është provuar se i mbrojturi im ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit H.B., av.F.Sh. deklaroi se i akuzuari H.B. është puntor shumvjeqar pranë Agjensionit të pyjeve, i njejti ka kryer të gjitha punët dhe detyrat sipas kontrates së punës dhe ditën kritike ka qenë në funksion të detyres, edhe pse mbulon teritor tjetër, i njejti tërë naten së bashku me koleget tjerë ka përmbushur të gjitha detyrat e marrura në përgjegjësi, në mënyrë vullnetare edhe pse nuk ka qenë obligim i tij , ka ndihmuar në transportin e mases drurore. I akuzuari gjatë tërë kohës s aka zgjatur procedura penale është sjellur në mënyrë korrekte dhe ka bashkupunuar si më organet e ndjekjes ashtu edhe me prokurorin dhe gjykatën, karakteristikat e tij personale janë të nivelit të lartë , nuk ka dosje kriminale nga se i njejti kurr nuk ka renë ndesh me ligjin. Propozon që gjykata të mere aktgjykim lirues në mungesë të provave.

Mbrojtësi i të akzuarit A.G., avokati A.B. në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se duke u bazuar në pretendime dhe deklarata të mbrojturit tim të dhënë para organeve shtetërore dhe në polici prokurorisë si dhe gjatë mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore në këtë gjykatë, i mbrojturi im nuk ka pranuar veprën penale për të cilën dyshon prokuroria e shtetit. I mbrojturi im qëndron pranë atyre deklaratave të dhëna mirëpo gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore është vërtetuar se imbrojturi im nuk është involvuar në këtë veprë penale kjo lënë për të kuptuar që i përket deklaratave të dëshmitarëve, mirëpo mbrojtja kërkon nga gjykata të vlerësojë se deklarata e H.K.1 ka qenë jo e sinqertë, ma tepër ka qenë inonjures, e dyshimtë duke kërkuar që kësaj deklarate gjykata mos t'ia falë besimin. Duke u bazuar në deklaratën e të mbrojturit tim, kërkojë nga gjykata që në kuptim të nenit 364 par.1 p.1.2dhed 1.3 të bjerë aktgjykim lirues. Pastaj mbrojtësi vazhdon duke thënë se i mbrojturi im është i shtyer në moshë, asnjëherë nuk ka qenë i dënuar apo i ndjekur për vepra të llojit të tillë, ka pranuar telefonatën dhe ka dhënë ndihmën nga dëshmitari H.K.1 i cili ka qenë i informuar për tubën e druve e kursesi për traktora.

Mbrojtësi i të akzuarit B.G. av. N. Q. , në fjalën e tij përfundimtare gjithashtu e ka deponuar me shkrim i cili ndër të tjera ka deklaruar se nuk është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar në aktakuzë, ku mungojnë provat që vërtetojnë dyshimin e bazuar, me asnjë rrethanë nuk mundë të vërtetohet asnjë veprim i kundërligjshëm i ndaluar dhe inkriminues, aktakuza nuk ka asnjë bazë kligjore, ndaj të akzuarit duhet të mirret aktgjykim lirues konformë nenit 364 të KPP.

Mbrojtjen e të akzuarve S.J. ,H.K. , A.Sh. , H.B., A.G. dhe B.G., gjykata nuk e pranoi sepse mbrojtja e tyre ishte në kundërshtim me gjendjen e vërtetuar faktike gjatë shqyrtimeve kryesore, sepse kjo mbrojtje ishte e orjentuara në drejtim të shmangjes së përgjegjësis penale-juridike, se ata me çdo kusht janë munduar të paraqesin pafajsinë e tyre, mirëpo trupi gjykues duke u mbështetur edhe në deklaratat e disa dëshmitarve të propozuar nga mbrojtësit, dëshminë e tyre nuk ju fali besimin meqë ishin kontradiktore si me vetvetën e edhe në raportë me dëshmit e dëshmitarve të tjerë, e sidomos me dëshmit e dëshmitarve H.K.1, I.S., Sh. B. dhe Xh.K. .

Dëshmitaret : M.H., H.D., Xh. D., Xh.E., S.Sh., Y.D. dhe R.H., të cilet janë propozuar nga mbrojtja e të cilet janë ftuar dhe të ndëgjuar gjatë shqyrtimeve kryesore, aspak nuk kanë kontribuar në drejtim të zbardhjes së gjendjës faktike të kësaj qeshtje penale dhe dëshmit e tyre nga trupi gjykues u konsideruan si të parëndësishme.

Tezën e avoketeve mbrojtës: se nuk është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në aktakuzë, mungojnë provat, asnjë rrethanë nuk mundë të vërtetohet se të mbrojturit e tyre kanë kryer veprën penale apo do të kishin vërtetuar ekzistimin e vepres penale, përgjegjësinë e tyre etj, me propozim që trupit gjykues që të nxjerrë aktgjykim lirues në mungesë të provave, trupi gjykues i hudhi si të pabazuara, sepse provat materiale dhe dëshmitë e disa prej dëshmitarve ishin bindëse që vërtetuan kryerjen e vepres penale nga ana e të akuzuarve.

Gjykata pas administrimit të provave materiale, pas analizimit të dëshmive të dëshmitarëve, mbrojtjes së të akzuarëve erdhi në përfundim se në veprimet e të akzuarëve S.J., H.K., A.Sh., H.B., A.G. dhe B. G., formohen të gjitha nga neni 422 par.1 lidhur me

par.2.1, 2.2 dhe 2.4 e lidhur me nenin 31 të KP, sepse në eprimet e të akuzuarëve janë formuar të gjitha elementet qenësore të kësaj vepre penale për çka gjykata të njejtit i shpalli fajtor dhe ua shqiptojë dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e bindur se edhe me këtë masë do të arrihet qëllimi i dënimit .

Gjykata gjithashtu aprovoi kërkesën e përfaqësuesit të akuzës të parashtruar në fjalën përfundimtare që gjykata në bazë të dispozitave nga neni 62 par.2 të KPP, të pandehurit ti shqiptohet dënimi plotësues, ndalimi i ushtrimit udhëheqëse dhe menaxheriale në institucionet publike.

Gjykata, gjatë shqiptimit dhe matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, e në kuptim të nenit 73 të KP-së, pati parasyshtë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësin e dënimit, minimumin e dënimit të parapara për secilën vepër penale e në rastin konkret minimumin për vepren penale nga neni 422 par.1 lidhur me par.2.1, 2.2 dhe 2.4 e lidhur me nenin 31 të KP, si rrethanë rënduese gjykata pati parasyshtë shkallën e përgjegjësisë penale, intenzitetin e rrezikimit të vlerës ë mbrojtur dhe se veprat penale padyshim se e kanë kryer me dashje eventuale duke qenë në tërësi i vetëdijshëm për shkaktimin e pasojave për këtë vepër penale respektivisht ka pranuar që të shkaktojë pasojat e ndaluara me Ligj. Gjykata pati parasyshtë edhe rrethanë posaqërisht lehtësuese, sjelljen korrekte e të akuzuarve gjatë shqyrtimit kryesor, të gjith të akuzuarit janë familjar dhe gjerë më tani të padenduar dhe në këto rrethana, gjykata aplikoj edhe nenin 74 dhe nenin 75 të KP, kur shqiptoj dënimin em kushtëzuar me burg në minimumin e kufirit të parapara me ligj, e bindur se edhe me këtë masë do të arrihet qëllimi i dënimit.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike u muar në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPP.

Vendimi mbi paushallit gjyqësor, gjykata e bazoi në dispozitat e nenit 450 par.2 pika 6 të KPP.

Andaj, nga të cekurat si më lartë është vendosur si në shqiptim të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti për Krime të Rënda
P.nr.239/2015, dt.25.01.2017

Sek.juridike,
Fatmire Kastrati

Kryetari i trupit gjykues
Xheladin Osmani

UDHËZIMI JURIDIK: kundër këtijë aktgjykimi pala e paknaqur mundë të ushtrojë ankesë në afatin prej 15 ditëve nga dita e pranimit, Gjykates së Apelit në Prishtinë, nepermjet të kësaj gjykate.